



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 191

6 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 1021, datë 27.11.2013	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë..... 7909
Vendim i KM nr. 1022, datë 27.11.2013	Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për disa institucione të varësisë, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për këtë ministri..... 7909
Vendim i KM nr. 1026, datë 27.11.2013	Për lejimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Për shtypjen e teksteve mësimore” dhe botimit të çdolloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim 7910
Vendim i KM nr. 1027, datë 27.11.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 553, datë 12.8.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, të naftësjellësve e gazsjellësve”, të ndryshuar..... 7911
Vendim i KM nr. 1028, datë 27.11.2013	Për pjesëmarrjen në stërvitjen shumëkombëshe të një kompanie këmbësorie të komandës së forcës tokësore dhe të një toge të policisë ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani..... 7912
Vendim i KM nr. 1029, datë 27.11.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, të ndryshuar..... 7913
Vendim i KM nr. 1030, datë 27.11.2013	Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte..... 7913

Vendim i KM nr. 1031, datë 27.11.2013	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.....	7914
Vendim i KM nr. 1032, datë 27.11.2013	Për lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Blerja e sistemit të shfrytëzimit, paketa <i>office</i> dhe <i>software</i> , për menaxhimin e laboratorëve të informatikës në shkolla” dhe të botimit të çdolloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim	7915
Vendim i KM nr. 1035, datë 27.11.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar .	7916

VENDIM
Nr. 1021, datë 27.11.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të pakësohet fondi prej 20 900 000 (njëzet milionë e nëntëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07450 “Shërbimet e shëndetit publik”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të pakësohet fondi prej 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të shtohet fondi prej 24 300 000 (njëzet e katër milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1022, datë 27.11.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES,
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR DISA
INSTITUCIONE TË VARËSISË, ME FONDET E MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT
2013 PËR KËTË MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për disa institucione të varësisë, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për këtë ministri, për objektet sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.



2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Procedurat e prokurimit me objekt:

1. SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë:

“Blerje biomase (Pellet) për ngrohje të institucionit”, me fond limit 5.800.000 lekë me TVSH.

2. Drejtoria e spitalit Lushnjë:

“Blerje lëndë djegëse për kaldajën (Solar), fondi limit 1.500.000 lekë me TVSH.

3. Shërbimi Spitalor Pogradec:

“Blerje karburanti për ngrohje për kaldajën e spitalit”, fondi limit 2.630.833 lekë pa TVSH.

4. Shërbimi Spitalor Kurbin:

“Blerje lëndë djegëse për kaldajën (Solar)”, fondi limit 666.667 lekë me TVSH.

5. Spitali Psikiatrik Elbasan:

“Blerje materialesh të buta për Spitalin Psikiatrik Elbasan”, fondi limit 4.203.000 lekë me TVSH.

VENDIM

Nr. 1026, datë 27.11.2013

PËR LEJIMIN E SHTËPISË BOTUESE TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT “PËR SHTYPJEN E TEKSTEVE MËSIMORE” DHE BOTIMIT TË ÇDOLLOJ NJOFTIMI PROKURIMI PËR KËTË SHËRBIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Për shtypjen e teksteve mësimore”, me fond limit 2 715 000 (dy milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, miratuar në buxhetin e vitit 2013 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dhe botimit të çdolloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1027, datë 27.11.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 553, DATË 12.8.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE TË
KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E RAFINERIVE, TË
NAFTËSJELLËSVE E GAZSJELLËSVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 553, datë 12.8.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Ngritjen dhe funksionimin, pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, të komisionit të vlerësimit të kërkesave, i cili të ketë në përbërje përfaqësues nga:

- Ministria përgjegjëse për sektorin hidrokarbur 3 (tre) anëtarë;
- Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban dhe turizmin 1 (një) anëtar;
- Ministria përgjegjëse për financat 1 (një) anëtar,
- Ministria përgjegjëse për ekonominë 1 (një) anëtar;
- Ministria përgjegjëse për mjedisin 1 (një) anëtar;
- Ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën 1 (një) anëtar;
- Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike 1 (një) anëtar.

Ministri përgjegjës për sektorin hidrokarbur zgjedh kryetar njërin prej anëtarëve të komisionit.

a) Komisioni i vlerësimit të kërkesave vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij vendimi.

Në rast se për të njëjtin territor ka më shumë se një shoqëri që plotëson të njëjtat kushte për dhënie e lejes së kërkuar, si kriter për përzgjedhje komisioni të përdorë vlerën e bonusit që ofron secila shoqëri në dispozicion të buxhetit të shtetit.

b) Mënyra e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për sektorin hidrokarbur, ministrit përgjegjës për ekonominë, ministrit përgjegjës për zhvillimin urban dhe turizmin dhe ministrit përgjegjës për financat. Udhëzimi duhet të dalë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.”.

2. Shkronja “a” e pikës 9, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Leja e koncesionit negociohet dhe përgatitet nga një grup pune me përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për sektorin hidrokarbur, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, ministrisë përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën, ministrisë përgjegjëse për zhvillimin urban dhe turizmin, ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Ministrisë së Drejtësisë me subjektin kërkuar ose përfaqësuesin ligjor të tij.”.

3. Pika 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

“17. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.”.



4. Në këtë vendim, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, emërtimi “Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për sektorin hidrokarbur” dhe “ministra përgjegjëse për ekonominë”; emërtimi “Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për zhvillimin urban dhe turizmin”; emërtimi “Ministria e Financave” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për financat”; emërtimi “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën”; emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për mjedisin”; emërtimi “Ministria e Brendshme” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike”; emërtimi “Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohet me “Këshilli Kombëtar i Territorit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1028, datë 27.11.2013

**PËR PJESËMARRJEN NË STËRVITJEN SHUMËKOMBËSHE TË NJË KOMPANIE
KËMBËSORIE TË KOMANDËS SË FORCËS TOKËSORE DHE TË NJË TOGE TË
POLICISË USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË QENDRËN E BASHKUAR NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË
(JMRC) NË HOHENFELS, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në stërvitjen shumëkombëshe të një kompanie këmbësorie të Komandës së Forcës Tokësore dhe të një toge të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me personel 150 ushtarakë, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

2. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi i trupave dhe rritja e kapaciteteve operacionale dhe e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Kohëzgjatja e stërvitjes është nga data 14.1.2014 deri në datën 4.2.2014.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1029, datë 27.11.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 459, DATË 23.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit nr. 459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimet “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”.

2. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1030, datë 27.11.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE E TË KRITEREVE TË SIGURISË, PJESA
E PARË, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE
OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES TË GAZIT
NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-SË, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT
DHE TË LINJAVE DIREKTE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi. Në pjesën e parë të rregullave teknike për industrinë e gazit përfshihen rregulla për sistemin e transmetimit, referuar kodeve të praktikave në vazhdim, si më poshtë vijon:

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G463 “Linjat e gazit me tuba çeliku për presion operimi mbi 16 bar-konstruksioni”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G466-1 “Linjat e gazit me tuba çeliku për presion operimi mbi 5 bar-mirëmbajtja”.



- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G469 “Metodat e testimit nën presion për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G488 “Impiantet për matjen e cilësisë së gazit: projektimi, ndërtimi, operimi”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G491 “Stacionet e rregullimit të presionit të gazit për presionet hyrëse deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, instalimi, testimi, komisionimi dhe operimi”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G492 “Stacionet e matjes së gazit për një presion operimi deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, ndërtimi, testimi, komisionimi, operimi dhe mirëmbajtja”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G497 “Stacionet e kompresorëve”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G497-B1 suplementi 1 “Zonat me rrezik shpërthimi në stacionet e kompresorëve”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G499 “Parangrohja e gazit natyror në impiantet e gazit”.

2. Rregullat dhe kriteret e sigurisë, të miratuara me urdhrin nr. 666, datë 3.8.2009 të ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë, të përkohshme, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, të jenë në fuqi deri në miratimin e plotë të rregullave e të kriterëve të sigurisë të sistemeve të gazit natyror, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

3. Deri në miratimin e plotë të të gjitha rregullave dhe kriterëve të sigurisë për sektorin e gazit, operimi i infrastrukturës ekzistuese së gazit natyror të jetë objekt i rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1031, datë 27.11.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09240 “Arsimi i mesëm profesional”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të zbritet fondi prej 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të zbritet fondi prej 7 664 422 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të shtohet fondi prej 37 985 693 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të shtohet fondi prej 11 678 729 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1032, datë 27.11.2013

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT “BLERJA E SISTEMIT TË SHFRYTËZIMIT, PAKETA *OFFICE DHE SOFTWARE*, PËR MENAXHIMIN E LABORATORËVE TË INFORMATIKËS NË SHKOLLA” DHE TË BOTIMIT TË ÇDOLLOJ NJOFTIMI PROKURIMI PËR KËTË SHËRBIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Blerja e sistemit të shfrytëzimit, paketa *office* dhe *software*, për menaxhimin e laboratorëve të informatikës në shkolla”, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2013 për këtë ministri, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 1035, datë 27.11.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 12 të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Spitalit Ushtarak të Forcës Tokësore, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura.”.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë;

b) infermierët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë;

c) mjekët dhe punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë në Spitalin Ushtarak të Forcës Tokësore;

ç) mjekët ushtarakë dhe civilë në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë);

d) infermierët civilë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

2. Lidhja nr. 1 (krerët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9) dhe lidhja nr. 2 (krerët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7) të përmendura në pikën 2, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Pika 8 shfuqizohet.

4. Lidhja nr. 4 e përmendur në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Pas pikës 15 shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1. Punonjësit e Spitalit Ushtarak të Forcës Tokësore, të cilët, deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përfitonin një pagë më të lartë sesa paga e parashikuar në lidhjet përkatëse të këtij vendimi, do të përfitojnë një pagë në ruajtje, por jo më shumë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Paga në ruajtje llogaritet si diferencë midis pagës bruto që përfitonin punonjësit para hyrjes në fuqi të këtij vendimi me pagën bruto që ata do të përfitojnë pas hyrjes në fuqi të tij.”.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondi për politikat e pagave për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1 (kreu 1.1)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR
OBSETRIK GJINEKOLOGJIK NR. 1, NR. 2 TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR TË
SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE “SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKËN
STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË DHE SPITALIN UNIVERSITAR TË
TRAUMËS TIRANË**

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor i: - QSU “Nënë Tereza” Tiranë - Spitalit Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë - Spitalit Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë - Spitalit të Sëmundjeve të Mushkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë - Spitalit Universitar të Traumës	14000	2%	0	107800		Nga..deri ...lekë
2	Drejtor - Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë Zëvendësdrejtor i QSU “Nënë Tereza” Tiranë	14000	2%	0	91700		Nga..deri ...lekë
3	Zëvendësdrejtor në spitalet e tjera universitare	14000	2%	0	74400		Nga..deri ...lekë
4	Shef shërbimi infektiv në QSUT	14000	2%	0	65200	8000	
5	Shef shërbimi Shef i sektorit biomedikal	14000	2%	0	65200		Nga..deri ...lekë
6	Shef reparti infektiv në QSUT	14000	2%	0	57000	8000	
7	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.) Shef i Qendrës së Gruas	14000	2%	0	57000		Nga..deri ...lekë
8	Shef reparti/klinike reanimacioni	14000	2%	0	57000	1100	Nga..deri ...lekë
9	Shef reparti/klinike psikiatrie	14000	2%	0	57000	5000	Nga..deri ...lekë
10	Shef i laboratorit klinik biokimik Shef reparti kimioterapi Shef laborator Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare	14000	2%	0	57000	2200	Nga..deri ...lekë



11	Shef reparti rrezatimi Shef reparti i Kyrisë	14000	2%	0	57000	4600	Nga..deri ...lekë
12	Shef kabineti Shef i Qendrës së Protezimit. Inxhinier biomedikal	14000	2%	0	51500		Nga..deri ...lekë
13	Shef sektori Shef farmacie në solucionet e injektueshme Biokimist në solucionet e injektueshme Inxhinier i sistemeve të ngrohjes Inxhinier hemodialize	14000	2%	0	51500		Nga..deri ...lekë
14	Mjek Stomatolog Biolog, kimist, fizikan në preparatori Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog Përgjegjës qendre DDD Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji)	14000	2%	0	48200		Nga..deri ...lekë
15	Mjek infeksionist në QSUT	14000	2%	0	48200	8000	
16	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale) Mjek onkolog Mjek fizioeterapevt Mjek obseter gjinekolog Mjek pneumoftiziatër	14000	2%	0	48200	1100	Nga..deri ...lekë
17	Mjek radilolog Toksikolog, kimist, në laboratorin toksikologjik Kimist në laboratorin biokimik Fizikan në laboratorin biokimik Biolog në laboratorin biokimik	14000	2%	0	48200	1600	Nga..deri ...lekë
18	Mjek radiolog, në shërbimin infektiv në QSUT Mjek në kabinetin e ekografisë, në shërbimin infektiv në QSUT	14000	2%	0	48200	8000	
19	Mjek kimioteapeut Mjek hematolog Mjek infeksionist Mjek në pranim urgjence Mjek në njësinë nozokomiale Mjek laborator Mjek histopatolog Mjek në shërbimin e gjakut	14000	2%	0	48200	2000	Nga..deri ...lekë
20	Mjek në Inspektoratin Sanitar Inspektor sanitar Epidemilog Farmacist	14000	2%	0	48200	2500	Nga..deri ...lekë
21	Farmacist në laboratorin toksikologjik Mjek laborator izotopik Fizikan, kimist laborator izotopik Mjek në hemodinamikë Fizikan në higjienë dhe epidemilogji Inxh. kimist në shërbimin e higjienës Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike	14000	2%	0	48200	2800	Nga..deri ...lekë
22	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziat, reanimator Mjek në pavionin e rrezatimit Mjek në pavionin e Kyrisë Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Fizikan kobalti	14000	2%	0	48200	3700	Nga..deri ...lekë

23	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në Psikiatri	14000	2%	0	48200	5000	Nga..deri ...lekë
24	Inspektor auditi	14000	2%	0	35500		Nga..deri ...lekë
25	Specialist i lartë	14000	2%	0	34000		Nga..deri ...lekë

Lidhja 1 (kreu 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
EMËRTIMI		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Titullar i drejtorive rajonale. Titullar në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës	14000	2%		74400	9000	Nga..deri ...lekë
2	Drejtor dhe kryeinspektor sanitar në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe	14000	2%		65200	9000	Nga..deri ...lekë
3	Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të shëndetësisë dhe drejtor i drejtorive të shëndetit publik në rrethe	14000	2%		57000		Nga..deri ...lekë
4	Zëvendëstitullar në drejtoritë rajonale, në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe	14000	2%		57000		Nga..deri ...lekë
5	Shef shërbimi i kujdesit parësor Shef shërbimi urgjence Shef shërbimi i mjekësisë familjare	14000	2%		50000		Nga..deri ...lekë
6	Shef shërbimi i higjienës Shef shërbimi i epidemiologjisë	14000	2%		50000	9000	Nga..deri ...lekë
7	Shef shërbimi stomatologjik	14000	2%		50000	3300	Nga..deri ...lekë
8	Përgjegjës i Shërbimeve të Shëndetit Mendor	14000	2%		45000	5000	Nga..deri ...lekë
9	Shef sektori Shef reparti Shef kabineti Shef/përgjegjës laborator Përgjegjës dispancerie	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë
10	Specialist i lartë në higjienë Specialist i lartë në epidemiologji	14000	2%		38200	7000	Nga..deri ...lekë
11	Epidemiolog Higjienist	14000	2%		38200	8000	Nga..deri ...lekë
12	Inspektor stomatolog	14000	2%		38200	1100	Nga..deri ...lekë
13	Shef reparti/laboratori në higjienë Shef reparti/laboratori në epidemiologji	14000	2%		38200	9000	Nga..deri ...lekë
14	Mjek Stomatolog Inxhinier elektrik Kimist	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë



	Veteriner Mikrobiolog						
15	Mjek ftzioterapevt Mjek kirurg Mjek ortoped Mjek pneumoftiziatër	14000	2%		38200	1100	Nga..deri ...lekë
16	Mjek radiolog Mjek hematolog Mjek onkolog	14000	2%		38200	1600	Nga..deri ...lekë
17	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Shërbimet e Shëndetit Mendor	14000	2%		38200	5000	Nga..deri ...lekë
18	Përgjegjës zyre Revizor Inspektor	14000	2%		38200	1100	Nga..deri ...lekë
19	Specialist me arsim të lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë
20	Specialist i lartë promocioni	14000	2%		31050	4000	

Lidhja I (kreu 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE, DHE MJEKËT DHE PUNONJËSIT E TJERË CIVILË ME ARSIM TË LARTË NË SPITALIN USHTARAK TË FORCËS TOKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
EMËRTIMI		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		74400		Nga..deri ...lekë
2	Shef shërbimi në anatomopatologji	14000	2%		57000	3500	Nga..deri ...lekë
3	Zëvendësdrejtor	14000	2%		51000		Nga..deri ...lekë
4	Shef shërbimi	14000	2%		50000		Nga..deri ...lekë
5	Shef shërbimi reanimacioni Shef shërbimi infektiv Shef shërbimi obsetrik gjinekologjik Shef shërbimi kirurgji Shef shërbimi ortopedi	14000	2%		50000	1100	Nga..deri ...lekë
6	Shef shërbimi radiologji Shef shërbimi neuropsikiatri	14000	2%		50000	1600	Nga..deri ...lekë
7	Shef shërbimi psikiatri	14000	2%		50000	5000	Nga..deri ...lekë
8	Shef reparti/klinike Përgjegjës/shef kabineti Përgjegjës/shef laboratorit/poliklinike/fizioterapi	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë

9	Shef i Bankës së Gjakut Shef reparti radiologjie Shef reparti pneumoftiziatr	14000	2%		38200	1100	Nga..deri ...lekë
10	Shef reparti/klinike psikiatri	14000	2%		38200	5000	Nga..deri ...lekë
11	Përgjegjës laborator klinik biokimik	14000	2%		38200	2500	Nga..deri ...lekë
12	Përgjegjës/shef reparti anatomopatologji	14000	2%		38200	3700	Nga..deri ...lekë
13	Mjek Stomatolog Biolog Kimist Fizikan Shef sektori Përgjegjës zyre Inxhinier biomedikal	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë
14	Mjek infeksionist Mjek urgjence Mjek laborator Kimist, fizikan laborator Kimist në shërbimin e gjakut	14000	2%		38200	600	Nga..deri ...lekë
15	Mjek onkolog Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale) Mjek hematolog Mjek i Bankës së Gjakut Mjek obsetër gjinekolog Mjek pneumoftiziatër Mjek fizioterapeut	14000	2%		38200	1100	Nga..deri ...lekë
16	Mjek radiolog	14000	2%		38200	1600	Nga..deri ...lekë
17	Mjek higjienist Farmacist	14000	2%		38200	2500	Nga..deri ...lekë
18	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziist reanimator	14000	2%		38200	3700	Nga..deri ...lekë
19	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Psikiatri	14000	2%		38200	5000	Nga..deri ...lekë
20	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë

Lidhja I (kreu 1.4)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
EMËRTIMI		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		74400		Nga..deri ...lekë
2	Zëvendës drejtor	14000	2%		65200		Nga..deri ...lekë



3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave	14000	2%		57000		Nga..deri ...lekë
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	14000	2%		45800		Nga..deri ...lekë
5	Farmacist Analist	14000	2%		45800	4000	Nga..deri ...lekë
6	Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik	14000	2%		45800	5000	Nga..deri ...lekë
7	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë

Lidhja 1 (kreu 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
EMËRTIMI		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		63000		Nga..deri ...lekë
2	Shef sektori	14000	2%		50000		Nga..deri ...lekë
3	Mjek. Stomatolog	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë

Lidhja 1 (kreu 1.6)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E INXHINIERISË BIOMJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
EMËRTIMI		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		65200		Nga..deri ...lekë
2	Shef sektori	14000	2%		50000		Nga..deri ...lekë
2	Përgjegjës i zyrës teknike Përgjegjës reparti	14000	2%		43500		Nga..deri ...lekë
3	Inxhinier biomedikal	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë
4	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë

Lidhja 1 (kreu 1.7)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

		PAGA MUJORE					
EMËRTIMI		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		Totali
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		74400		Nga..deri ...lekë
2	Zëvendësdrejtor	14000	2%		57000		Nga..deri ...lekë
3	Përgjegjës i sektorit të laboratorëve Shef i Bankës së Gjakut	14000	2%		50000	2500	Nga..deri ...lekë
4	Shef sektori	14000	2%		38200		Nga..deri ...lekë
5	Mjek, kimist	14000	2%		38200	1600	Nga..deri ...lekë
6	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë

Lidhja I (kreu 1.8)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË NJËSINË E
TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTERË

		PAGA MUJORE					
EMËRTIMI		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		Totali
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	
		1	2	3	4	5	
1	Shef i njësisë	14000	2%		74400		Nga..deri ...lekë
2	Kryepilot	14000	2%		73000	8000	Nga..deri ...lekë
3	Pilot	14000	2%		71000	8000	Nga..deri ...lekë
4	Teknik helikopteri	14000	2%		68000		Nga..deri ...lekë
5	Shef sektori	14000	2%		41300		Nga..deri ...lekë
6	Specialist i lartë	14000	2%		31050		Nga..deri ...lekë



Lidhja 1 (kreu 1.9)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË, AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE
SHËNDETËSORE DHE QENDRËS KOMBËTARE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	14000	2%		91700		Nga..deri ...lekë
2	Shef sektori	14000	2%		57000		Nga..deri ...lekë
3	Specialist i lartë	14000	2%		45800		Nga..deri ...lekë

Lidhja nr. 2 (kreu 2.1)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR
OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË
“SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË
DHE SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS TIRANË**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiere		2%	0	34000	3600	Nga ... deri
2	Kryeinfermier shërbimi psikiatrik		2%	0	34000	6000	
3	Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në QSUT		2%	0	34000	8000	
4	Kryelaborantë në shërbimin e anatomisë patologjike. Kryeinfermier shërbimi i terapisë intensive. Kryeinfermiere shërbimi onkologjik. Kryelaborant rrezatim kobalti Kryelaborant në histopatologji. Kryeinfermierë të repartit të rrezatimit		2%	0	34000	3400	
5	Kryeinfermierë reparti psikiatrik		2%	0	34000	5000	
6	Kryeinfermierë reparti në shërbimin infektiv në QSUT		2%	0	34000	8000	
7	Kryeinfermierë shërbimi Neurokirurgji Kryemami e përgjithshme Kryeinfermier/kryemami reparti i terapisë intensive		2%	0	34000	2600	

8	Kryeinfermierë kimioterapi. Kryelaborant klinik biokimik. Kryeinfermiere në urgjencën e sëmundjeve të brendshme Kryeinfermiere/mami salle Kryeinfermiere/mami e dhomës së zgjimit Infermierë në hemodinamikë. Kryelaborant imunolog, bakteriolog	2%	0	34000	1800	
9	Kryeinfermierë shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik) Kryeinfermier/kryemami në repartin e kirurgjisë. Kryemami turni në kirurgji Kryemami turni në obsetrikë. Kryeinfermierë reparti infektiv. Kryeinfermierë reparti (fizioterapi, urologji, të urgjencë së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji) Kryeinfermiere/kryemami salle operacioni	2%	0	34000	1100	
10	Kryeinfermiere shërbimi. Kryelaborante shërbimi. Kryemami shërbimi	2%	0	34000		
11	Infermier/laborant në psikiatri	2%	0	32000	5000	
12	Infermierë në kyriterapi. Laborant histopatolog	2%	0	32000	3400	
13	Infermier/mami reanimacioni, neonatologji Infermiere në dhomën e zgjimit	2%	0	32000	2650	
14	Infermiere në kimioterapi	2%	0	32000	1800	
15	Kryelaborant radiologjie	2%	0	32000	1500	
16	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiere Kryeinfermiere e edukimit shëndetësor TB	2%	0	32000	1100	
17	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë Kryeinfermierë në sterilizim. Kryemami në izolim	2%	0	32000		
18	Laborant radiolog në onkologji	2%	0	28000	3700	
19	Laborant rrezatim kobalti	2%	0	28000	3400	
20	Laborant në mjekësinë bërthamore	2%	0	28000	2650	
21	Infermierë në njësinë e Inspektoratit Sanitar dhe infeksioneve nazokomiale. Infermierë në sallën e operacionit	2%	0	28000	2100	
22	Kryeinfermier reparti pranim urgjence Laborant klinik biokimik. Infermier në pункtin e gjakut. Infermier në hematologji. Infermier në onkologji. Infermiere endoskopie Infermier/laborant bakteriolog, imunolog	2%	0	28000	1800	
23	Infermier reparti radiologjik. Laborant radiolog. Kryeinfermiere (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) Kryemami në qendrën e gruas	2%	0	28000	1500	
24	Infermier/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike). Instrumentarë	2%	0	28000	1100	
25	Kryeinfermierë neonatologji. Kryemami pranimi. Kryeinfermiere në kabinetin e	2%	0	28000		



	dializës Kryemami/kryeinfermierë reparti. Kryeinfermierë konsultash në sëmundjet e brendshme. Kryelaborant bakteriolog, imunolog, ortopedi stomatologjike) Infermierë sterilizimi					
26	Infermierë pavijoni rrezatimi		2%	0	27000	3310
27	Infermierë në shërbimin infektiv në QSUT		2%	0	27000	8000
28	Infermierë (infektiv), pranim urgjence, njësia e koordinimit të urgjencës)		2%	0	27000	1800
29	Ndihmësfarmacist. Infermierë në hemodializë		2%	0	27000	1500
30	Infermier fizioterapi		2%	0	27000	1100
31	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji) Kryeinfermierë çerdhe për personelin Infermier. Infermier çerdhe për personelin Kujdestar në pediatri		2%	0	27000	
32	Kujdestar në psikiatri		2%	0	24000	5000

Lidhja 2 (kreu 2.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	34000		Nga...deri ...lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	32000		
3	Ndihmësinsektor sanitar, ndihmëshigjienist, ndihmësepidemiolog Laborantë toksikologë Laborant bakteriolog/klinik biokimik		2%	0	28000	1100	
4	Infermierë në shërbimet e shëndetit mendor		2%	0	28000	5000	
5	Infermierë (hematologji, onkologji) Laborant rëntgeni		2%	0	28000	1500	
6	Infermier statistike		2%	0	27000		
7	Infermier ortopedi Infermier/laborant në fizioterapi		2%	0	27000	1100	
8	Kryeinfermier/kryemami Infermier në shërbimin stomatologjik Ndhimës dentist		2%	0	27000		
9	Ndhimësbakteriolog Infermier/mami		2%	0	24000		

Lidhja 2 (kreu 2.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE TIRANË, DHE INFERMIERËT CIVILË NË SPITALIN USHTARAK TË FORCËS TOKËSORE DHE NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike		2%	0	34000	6000	Nga..deri ...lekë
2	Kryeinfermier reparti në spitale psikiatrike		2%	0	34000	5000	
3	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	34000	1100	
4	Laborant në Anatominë Patologjike		2%	0	32000	3400	
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakteriologjik Kryeinfermier (kirurgji, reanimacion, sallë operacioni, obstetrikë gjinekologji)		2%	0	32000	1100	
6	Kryeinfermier		2%	0	32000		
7	Infermiere në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	28000	5000	
8	Infermiere reanimacioni Ndhmësanestezistë Ndhmësfarmacistë Laborant radiologjie Infermiere në radiologji Instrumentare Infermiere në hemodializë		2%	0	27000	1500	
9	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanseri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obstetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatr, onkologji, dispanseri) Infermierë në repartin e lindjes Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji Infermier/laborant në Bankën e Gjakut, Hematologji Përgjegjës turni		2%	0	27000	1100	
10	Kryeinfermiere në Qendrën e Sterilizimit. Infermier pranim urgjence Laborant klinik biokimik/bakteriologjik		2%	0	27000	600	
11	Infermier		2%	0	27000		
12	Kujdestar në Psikiatri		2%	0	24000	5000	
13	Kujdestar në Pediatri Ndhmësinfermier		2%	0	24000		



Lidhja 2 (kreu 2.4)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË LABORATORIN E KONTROLLIT TË
BARNAVE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant		2%	0	33000		Nga..deri ...lekë

Lidhja 2 (kreu 2.5)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË KLINIKËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier		2%	0	34000		Nga..deri ...lekë
2	Infermier. Ndihmësstomatologë		2%	0	27000		

Lidhja 2 (kreu 2.6)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier/kryelaborant		2%	0	32000		nga..deri ...lekë
2	Infermier. Laborant		2%	0	27000	1100	

Lidhja 2 (kreu 2.7)

STRUKTURA E PAGAVE PËR TEKNIKËT NË NJËSINË E TRANSPORTIT MJEKËSOR ME
HELIKOPTERË

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm Teknik elektrik		2%	0	32000		Nga..deri ...lekë

Lidhja nr. 4

Kualifikimi/ grada/ titulli shkencor	Paga (lekë/muaj)
Shef shërbimi nga kategoria “Profesor”	112.000
Shef shërbimi nga kategoria “Docent”	99.000
Profesor	110.000
Profesor i asociuar	96.000
Docent	87.000

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë